



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 696, Datë 11.06.2020

“Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA për abuzim me pozitën dominuese në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës” dhe dhënien e një rekomandimi MIE dhe MFE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

| | |
|----------------------|------------|
| Znj. Juliana LATIFI | Kryetar |
| Z. Eduard YPI | Zv/Kryetar |
| Znj. Leida MATJA | Anëtar |
| Znj. Adriana BERBERI | Anëtar |
| Z. Helidon BUSHATI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 11.06.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i raportit të hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës”.

Bazë ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 8, neni 9, pika 2 germat (a), neni 74, pika 1, germa (a), neni 75, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit mbi hetimin e thelluar ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës”;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi Raportin e hetimit të thelluar;
- Kundërshtimeve të paraqitura nga ndërmarrja “Durrës Container Terminal” SHA lidhur me “Raportin e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës”, nëpërmjet shkresës së saj nr. 158 prot, datë 08.05.2020 (protokolluar pranë AK me nr. 257/34 Prot., datë 11.05.2020);

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi kundërshtimet e paraqitura nga ndërmarrja DCT SHA.

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur:

1. Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës nga ndërmarrja Brunos SHPK lidhur me faturimin e padrejtë të shërbimit të zbrazjes dhe mbushjes së konteinerëve nga Koncesionari DCT SHA, filluan procedurat për vlerësimin e ankesës në respektim të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
2. Pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi vlerësimin e ankesës së ndërmarrjes Brunos SHPK ndaj Terminalit të Konteinerëve Durrës SHA (DCT)”, në mbështetje të nenit 9, nenit 24, shkronja (d) dhe nenit 42, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit nr. 627, datë 13.06.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
3. Në përfundim të hetimit paraprak Komisioni i Konkurrencës konkludoi se: sjellja e ndërmarrjes koncesionare DCT SHA duke ofruar shërbimin e mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve, kundërshtojnë një tarifë shtesë të vetëpërcaktuar në mënyrë të padrejtë dhe të pa miratuar, mund të përbëjë një abuzim me pozitën dominuese, (monopol) që zotëron ky koncesionar, në ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës, duke krijuar dyshimin e arsyeshëm se mund të jemi para shkeljes së nenit 9, pika 2, germa a), të ligjit nr. 9121, datë. 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar.
4. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 9, nenit 24 shkronja d, nenit 26 dhe nenit 43, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003, me anë të vendimit nr. 649, datë 03.10.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes "Durrës Container Terminal" SHA, në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA, për periudhën kohore nga 01.01.2018 deri në 30.09.2019.
5. Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës vlerësoi se jemi përpara një rasti urgjence të parashikuar në nenin 44 të ligjit nr. 9121/2003, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm për konkurrencën, pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 9 të këtij ligji. Bazuar në këtë vlerësim Komisioni i Konkurrencës, me

vendimin nr. 650, datë 03.10.2019, "Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës ndaj ndërmarrjes "Durrës Container Terminal" SHA", vendosi marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes "Durrës Container Terminal" SHA, në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës.

6. Në zbatim të vendimeve të mësipërme të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003 dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 257/23, datë 30.10.2019 "Autorizim inspektorësh", Inspektorët e Autoritetit, gjatë periudhës së hetimit të thelluar proceduan me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjes nën hetim DCT SHA, e cila ushtron veprimtarinë e saj në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës. Gjithashtu grupi i inspektimit, më datë 05.11.2019 realizoi një takim në ambientet e APD-së me përfaqësues të këtij Institucioni.
7. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, gjatë periudhës së hetimit të thelluar janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrja DCT SHA, Autoriteti Portual Durrës (APD) dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

8. Tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët dhe operatorët, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:
 - a) Tregu përkatës i produktit
 - b) Tregu përkatës gjeografik

II.1.a Tregu përkatës i produktit

9. Terminali i Konteinerëve Durrës është i përcaktuar si një nga facilitetet e portit të Durrësit që konsiston dhe përbëhet nga kalata nr. 6 dhe sheshet korresponduese, në përputhje me Master Planin e Portit të Durrësit, miratuar me VKM nr. 546, datë 28.05.2009.
10. Nga viti 2011, menaxhimi, operimi, ndërtimi, mirëmbajtja, përmirësimi teknik dhe adaptimi për përmbushjen e kërkesave aktuale dhe të ardhshme të trafikut në Terminalin e Konteinerëve Durrës është dhënë me koncesion.

11. Në bazë të kontratës së koncesionit, gjatë periudhës nën hetim, ky terminal menaxhohej dhe administrohej nga ndërmarrja DCT SHA, e cila ishte poseduesja dhe administruesja e vetme e të gjithë infrastrukturës dhe faciliteteve të këtij terminali, duke qenë 100% dominues në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkim të anijeve konteinerike dhe aktivitetet e lidhura me to në këtë terminal, ku përfshihet edhe shërbimi i zbrazjes dhe mbushjes së konteinerëve.
12. Bazuar në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 649, datë 03.10.2019, hetimi i thelluar është hapur në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës, ndaj ndërmarrjes "Durrës Container Terminal" SHA.
13. Referuar sa më sipër, *tregu përkatës i produktit përfshin ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve nga ndërmarrja koncesionare DCT SHA.*

II.1.b Tregu përkatës gjeografik

14. Bazuar në Masterplanin e miratuar dhe kontratën koncesionare, përpunimi i konteinerëve (ngarkim-shkarkimi i anijeve konteinerike dhe aktivitetet e lidhura me to) kryhet pranë Terminalit të Konteinerëve Durrës, ku ndërmarrja Koncesionare DCT SHA operon e vetme.
15. Referuar sa më sipër, *tregu përkatës gjeografik vlerësohet zona gjeografike e Terminalit të Konteinerëve në Portin e Durrësit.*
16. *Si përfundim, tregu përkatës përfshin ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës nga ndërmarrja koncesionare DCT SHA.*

II.2 Vlerësimi i Pozitës Dominuese

17. Vlerësimi i pozitës dominuese në treg është hapi i parë për të vazhduar me analizën e nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar), për sjellje të mundshme antikonkurrese në treg. Përkufizimi i pozitës dominuese është përcaktuar në nenin 3, pika 5 të ligjit, përkatësisht: "Pozitë dominuese" është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.
18. Sipas ligjit nr. 9121/2003, nuk është e ndaluar pozita dominuese nga një ose disa ndërmarrje në treg, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjeve një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese që zotëron dhe të mos kryejë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të këtij ligji.

19. Kriteret kryesore të vlerësimit të pozitës dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve, bazuar në nenin 8 të ligjit janë: pjesët e tregut përkatës, pengesat në hyrje në tregun përkatës, konkurrenca potenciale, fuqia ekonomike dhe financiare, varësinë ekonomike të furnizuesve dhe blerësve, fuqinë kundërvepruese të blerësve; zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes; karakteristika të tjera të tregut përkatës.
20. Terminali i Konteinerëve Durrës, në bazë të kontratës së koncesionit, duke filluar nga muaji Shkurt 2013 dhe gjatë gjithë periudhës nën hetim, operohej, menaxhohej dhe administrohej nga ndërmarrja DCT SHA, e cila ishte poseduesja dhe administruesja e vetme e të gjithë infrastrukturës dhe faciliteteve të këtij terminali. Çdo përdorues portit për të marrë shërbimet nga ky terminal, duhet patjetër të ketë akses në infrastrukturën dhe facilitetet që ofron ky terminal. Terminali ishte marrë me koncesion për 35 vjet nga ndërmarrja DCT SHA dhe për gjithë këtë periudhë kjo ndërmarrje do të ishte e vetme në këtë treg në qoftë se kontrata e koncesionit nuk do të ishte zgjidhur (Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, nr. 370 (86-2019-395), datë 12.02.2019). Por pavarësisht këtij vendimi ndërmarrja DCT SHA ka vazhduar të operojë në tregun objekt hetimi për gjatë gjithë periudhës nën hetim, gjë e cila është konfirmuar gjatë inspektimeve të zhvilluara pranë ambienteve të kësaj ndërmarrjeje si dhe raportimeve të dërguara nga APD dhe DCT SHA të cilat shpalosen gjatë analizës së sjelljes së kësaj ndërmarrjeje në vijim.
21. Duke marrë parasysh faktin që Koncesionari DCT SHA ishte posedues, operues, menaxhues dhe administrues i vetëm i infrastrukturës dhe faciliteteve të Terminalit të Konteinerëve Durrës edhe përgjatë gjithë periudhës nën hetim, duke zotëruar 100% të pjesëve të tregut përkatës; si dhe barrierat për hyrjen në treg; konkurrencën potenciale; fuqinë kundërvepruese të blerësve, bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, ndërmarrja DCT SHA vlerësohet me pozitë dominuese në tregun e ofrimit të shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve.

II.3 Sjellja e ndërmarrjes në treg

22. Ndërmarrja DCT SHA në bazë të kontratës Koncesionare ka pasur ekskluzivitet në ofrimin e shërbimeve të përpunimit të konteinerëve në portin e Durrësit. Si një ndërmarrje që operonte e vetme në këtë treg, për shërbimet që ajo ofronte aplikoheshin tarifa të miraturara paraprakisht nga APD dhe me Udhëzim të përbashkët të MIE dhe MFE.
23. Shërbimi i mbushjes- zbrazjes së konteinerëve është një shërbim që kryhet në rastet kur: nga ana e autoriteteve doganore kërkohet kontroll fizik i konteinerit; në rastet kur ky shërbim kërkohet nga vetë klienti; si dhe me kërkesë të AKU-së.
24. Ndërmarrja DCT SHA duke filluar nga muaji Maj 2018 ka ofruar shërbimet e mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve kundrejt një tarife të vetëpërcaktuar, tarifë e cila nuk ishte e miratuar dhe nuk ishte prezent në librin e tarifave të publikuara në faqen zyrtare të APD-së.

25. Koncesionari DCT SHA ka marrë miratimin e APD-së në 11 Maj 2018 për fillimin e ofrimit të shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve. Sipas APD faturimi i këtij shërbimi do të kryhej me vlerën e përcaktuar nga tarifat të cilat do të vendoseshin nga mbledhja e Këshillit Drejtues. Konkretisht ofrimi i këtij shërbimi nga DCT SHA ka filluar nga data 14.05.2018, duke aplikuar tarifat e propozuara nga vetë kjo shoqëri, konkretisht: për mbushje/zbrazje konteineri gjenerale 20 feet një tarifë prej 120 Euro/Box; për mbushje/zbrazje konteineri gjenerale 40 feet një tarifë prej 150 Euro/Box.
26. DCT SHA ka vijuar punën për përpunimin e konteinerëve duke ofruar edhe shërbimin e mbushjes dhe zbrazjes, kundrejt një tarife të vetëpërcaktuar dhe të pa miratuar nga instancat përkatëse, pavarësisht kërkesave të APD-së për ndërprerjen e ofrimit të këtij shërbimi, duke operuar në kundërshtim me termat e Kontratës Koncesionare si dhe me Librin e Tarifave Portuale. Lidhur me këtë sjellje të DCT-së, APD ka kërkuar ndërhyrjen e MIE si Autoriteti Kontraktor.
27. Në vijim të shqyrtimit të propozimit për tarifat e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve, Këshilli Drejtues i APD-së, me anë të vendimit nr. 21, datë 15.11.2018 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 5, datë 02.03.2015 “Mbi përcaktimin dhe miratimin e tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës për vitin 2015”, i ndryshuar, ka miratuar tarifat për mbushje/zbrazje konteineri gjenerale konkretisht si vijon: - Mbushje/zbrazje konteineri gjenerale 20 feet (20’) tarifa 65 Euro/Box; - Mbushje/zbrazje konteineri gjenerale 40 feet (40’) tarifa 86 Euro/Box.
28. Sipas pikës 2 dhe 4 të këtij vendimi, tarifat e miratuara sipas këtij vendimi i përcillen në formë propozimi për bashkëfirmosje Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë. Këto tarifa të miratuara hyjnë në fuqi sipas përcaktimit në aktin e miratimit nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë. Pavarësisht këtij miratimi paraprak të tarifës nga APD që nga muaji nëntor 2018, DCT SHA nuk e ka ndryshuar sjelljen e saj duke vazhduar ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së Konteinerëve me të njëjtën tarifë të vetëpërcaktuar, e cila ishte më e lartë se tarifa e miratuar për këtë shërbim nga APD, konkretisht 85% më e lartë për konteinerët 20’ dhe 43% më e lartë për konteinerët 40’.
29. Të ardhurat e siguruara nga ndërmarrja DCT SHA nga vendosja e tarifës për shërbimin e mbushjes-zbrazje së konteinerëve për periudhën Maj 2018 – Shtator 2019 janë 3,246,240 Lekë për konteinerët 20” dhe 34,009,500 për konteinerët 40”. Në total të ardhurat e siguruara nga ndërmarrja DCT SHA për periudhën Maj 2018 - Shtator 2019 nga shërbimi i mbushjes-zbrazje së konteinerëve 20” dhe 40” janë 37,255,740 Lekë, pa TVSH.
30. Në rastin e aplikimit të tarifave nga DCT SHA për ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve është përdorur metoda e krahasimit të kostos totale të

shërbimit me çmimin përfundimtar të aplikuar, duke qenë se tarifa e ofrimit të këtij shërbimi është e njëjtë për të gjithë përdoruesit e terminalit, nuk kemi një shërbim tjetër të ngjashëm me të, si dhe krahasimi i tarifave për shërbime të njëjta me porte të tjera mund të mos jetë i saktë pasi kostot e tyre janë të ndryshme.

31. Sipas analizës së kostos së bërë nga DCT SHA për ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve 20' dhe 40' me çmimet përkatësisht 120 Euro dhe 150 Euro të aplikuar nga DCT SHA për periudhën Maj 2018 – Maj 2019 bazuar në koston e fuqisë punëtore, koston e përdorimit të pirunit & Reach stacker, kosto vegla pune dhe veshje pune, ky shërbim rezulton me një fitim prej 2,702 Euro. Sipas DCT SHA nëse për të njëjtën periudhë do të aplikoheshin tarifat e miratuara nga APD me çmimet përkatësisht 65 Euro dhe 86 Euro ky shërbim do të rezultonte me një humbje prej 2,340 Euro, pasi APD ka bërë një llogaritje kostoje pa marrë parasysh volumin e punës, rasteve, kostot e shërbimit, etj.
32. Pavarësisht miratimit të tarifave nga APD që nga muaji nëntor 2018, DCT SHA ka filluar aplikimin e tyre nga marrja dijani e vendimit të KK nr. 650, datë 03.10.2019, “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA”, konkretisht nga muaji Tetor 2019.
33. Sa më sipër rezulton se gjatë periudhës nën hetim DCT SHA për ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve ka aplikuar tarifën e vetëpërcaktuara prej 120 Euro dhe 150 Euro, të cilat janë më të larta se tarifën e miratuara për këtë shërbim nga APD, konkretisht 85% më e lartë për konteinerët 20' dhe 43% më e lartë për konteinerët 40'. Pra kemi të bëjmë me çmime ekseseve, shumë të larta, pasi çmimi i aplikuar nuk ka lidhje të arsyeshme me vlerën ekonomike të produktit, koston e tij¹.
34. Duke qenë se për ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve nga DCT SHA nuk ka pasur një tarifë të miratuar nga Ministriat përkatëse, APD nuk ka arkëtuar asnjë të ardhur nga kryerja e këtij shërbimi. Gjatë procedurës së hetimit të thelluar APD ishte duke bërë rakordimet e evidencave të monitorimit për gjithë periudhën e ofrimit të këtij shërbimi dhe tarifa koncesionare do të mbahej për të gjitha këto shërbime të ofruara në momentin e miratimit të saj nga Ministritë.
35. Në bazë të kontratës Koncesionare DCT kishte ekskluzivitetin e shërbimeve të përpunimit të konteinerëve në Gjirin e Durrësit. Ushtrimi i kësaj të drejte përfshinte edhe të drejtën për të ofruar shërbimin e mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve si një shërbim i lidhur me shërbimet kryesore të ngarkim shkarkimit të konteinerëve, shërbim i cili është parashikuar si zë i veçantë në Udhëzimin e përbashkët të MIE dhe MFE Nr. 1568/3, datë 14.07.2015 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës për vitin 2015”, të ndryshuar, konkretisht në Kapitullin

¹ Neni 9, pika 1 dhe 2, gërma a, e Ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, përcakton qartë se të vendosësh çmime të padrejta apo kushte të padrejta tregtimi je para shkeljes së këtyre dispozitave. Termi “çmime të padrejta” i është referuar Gjykata Europiane e Drejtësisë dhe Komisioni Europian, në rastin e çmimeve ekseseve. Referuar këtyre rasteve të trajtuara nga Komisioni Europian dhe Gjykata Europiane e Drejtësisë, *çmim eksesev si përkufizim jepet çmimi që nuk ka lidhje të arsyeshme me vlerën ekonomike të produktit (Case 27/76 United Brands vs. Commission [1978] ECR 207, paragrafi 250).*

2, pika 2.12/5/Vii. Sipas këtij udhëzimi shërbimi i mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve, si shërbimet e tjera të renditura në nënpikën 5 si më sipër, faturohet dhe paguhet më vete. Referuar kontratës koncesionare dhe këtij udhëzimi, shërbimi i mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve është një shërbim ofrimi i të cilit i është dhënë ekskluzivisht koncesionarit. Por nga ana tjetër për këtë shërbim nuk rezulton asnjë tarifë e miratuar në këtë udhëzim.

36. Në kushtet kur, shërbimi i zbrazjes dhe mbushjes së konteinerëve nuk mund të kryhej jashtë sheshit doganor, terminalit të konteinerëve, për shkak të procedurave doganore, në zbatim të kontratës koncesionare ky shërbim nuk mund të kryhej nga persona ose subjekte që nuk janë kualifikuar ose licencuar për kryerjen e këtyre operacioneve, por vetëm nga koncesionari DCT SHA. Gjithashtu vetëm në këtë mënyrë nga të ardhurat e përfituara nga ky shërbim do të përfitonte edhe Autoriteti Kontraktor në formën e Tarifës Koncesionare dhe Pagësës së Koncesionit (Royalty) sipas marrëveshjes koncesionare (nenet 8.1 dhe 8.2).
37. Pavarësisht sa më sipër, në respektim të kontratës koncesionare (pika 2.5.1/(i)), DCT SHA merr përsipër që të mos aplikojë, zbatojë, vjelë, imponojë ose kërkojë, në çdo lloj forme, pagesa, tarifa, taksa apo pagesa të tjera të ndryshme të cilat përcaktohen në mënyrë ekskluzive nga Autoriteti Portual. Në rastin konkret DCT SHA ka aplikuar një tarifë shtesë në mënyrë të padrejtë, e cila nuk është e miratuar dhe nuk është prezent në librin e tarifave të publikuara në faqen zyrtare të APD-së.
38. Në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Komisioni i Konkurrencës, nëpërmjet shkresës nr. 257/33 prot, datë 22.04.2020 “Dërgim Raporti”, ka ftuar ndërmarrjen DCT SHA që të paraqisni me shkrim pretendimet mbi “Raportin mbi hetimin e thelluar ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës”.
39. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Konkurrencës, ndërmarrja DCT SHA nëpërmjet shkresës së saj nr. 158 prot, datë 08.05.2020 (protokolluar pranë AK me nr. 257/34 Prot., datë 11.05.2020), ka paraqitur pretendimet e saj mbi “Raportin e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës”, pretendime të cilat, në respektim të nenit 39 të ligjit 9121/2003, janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës në marrjen e këtij vendimi.

Si përfundim, referuar konkluzioneve të mësipërme, rezulton se sjellja e ndërmarrjes koncesionare DCT SHA, në kuptim të nenit 9, pika 2, germa a), të ligjit nr. 9121, datë. 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, përbën abuzim me pozitën dominuese (monopol) që zotëronte ky koncesionar, në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 8, nenit 9, pika 2 gërmat (a), nenit 24, shkronja (d), nenit 26, nenit 43, pika 5, nenit 45, pika 1, nenit 70, pika 2, nenit 74, pika 1,

gërma (a) dhe nenit 75, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës, gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit.
- II. Gjobitjen e ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA për shkelje të rëndë të konkurrencës konkretisht të nenit 9, pika 2, gërmat (a), të ligjit nr. 9121/2003, në masën 0,43 % të xhiros së ndërmarrjes të vitit paraardhës financiar, në shumën 5,052,370 Lekë.
- III. T’i rekomandoj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që brenda një afati 90 ditor, të marrin masat si vijon:
 - Rregullimin e tregut të shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës duke përcaktuar dhe miratuar tarifën përkatëse për këtë shërbim në udhëzimin e përbashkët për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës, me qëllim shmangien e sjelljeve të mundshme abuzive nga operatorë të këtij tregu.
- IV. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes "Durrës Container Terminal" SHA, në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës”.
- V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS